

32003L0041

Direktivë 2003/41/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 3 Qershor 2003, "Për veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e institucioneve të pensionit profesional"

Gazeta Zyrtare L 235, 23.09.2003 F. 0010 - 0021

Direktiva 2003/41/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 3 Qershor 2003, "Për veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e institucioneve të pensionit profesional"

PARLAMENTI EVROPIAN DHE KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin themelues të Komunitetit Evropian dhe, në veçanti, Nenin 47 paragrafi 2, Nenin 55 dhe Nenin 95, paragrafi 1 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Komisionit (¹),

Duke pasur parasysh opinionin e Komitetit Evropian Ekonomik dhe Social (²),

Duke vepruar në përputhje me procedurën e parashikuar në Nenin 251 të Traktatit (³),

Meqë:

1. Një treg i brendshëm i unifikuar i shërbimeve financiare është thelbësor për rritjen ekonomike dhe krijimin e vendeve të punës në Komunitet.
2. Aktualisht janë shënuar arritje të mëdha për krijimin e këtij tregu të brendshëm, që u lejon institucioneve financiare të operojnë në shtete të tjera anëtare dhe që siguron një nivel të lartë mbrojtjeje për konsumatorët e shërbimeve financiare.
3. Në komunikatën e Komisionit "Zbatimi i kuadrit për tregjet financiare: plani i veprimit" përcaktohen një seri masash të nevojshme për të plotësuar tregun e brendshëm të shërbimeve financiare, dhe Këshilli Evropian, në takimin e tij në Lisbonë në datat 23 dhe 24 Mars 2000, kërkoi zbatimin e këtij plani veprimi deri në vitin 2005.
4. Plan i veprimit për shërbimet financiare thekson, si prioritet urgjent, nevojën për hartimin e një direktive për mbikëqyrjen e matur të institucioneve të pensionit profesional, meqenëse këto institucione janë institucione financiare të mëdha që luajnë një rol kyç për sigurimin e integritetit, efikasitetet dhe likuiditetit të tregjeve financiare, por që nuk janë objekt i një kuadri ligjor koherent të Komunitetit, që u lejon atyre të përfitojnë plotësisht nga avantazhet e tregut të brendshëm.
5. Meqenëse sistemet e sigurimeve shoqërore po vihen nën presion të vazhdueshëm, pensionet profesionale do të përdoren gjithnjë e më shumë si plotësuese në të ardhmen. Prandaj, pensionet profesionale duhet të zhvillohen, pa vënë në pikëpyetje rëndësinë e sistemeve të pensionit të sigurimeve shoqërore, në aspektin e një mbrojtje sociale të sigurt, të qëndrueshme dhe efikase, e cila duhet të garantojë një standard të denjë jetese për moshën e thyer dhe, rrjedhimisht, duhet të jenë qendra e objektivit për forcimin e modelit shoqëror Evropian.

6. Në këtë mënyrë, kjo direktivë përbën hapin e parë në rrugën drejt organizimit të një tregu të brendshëm për ofrimin e pensionit profesional në nivel Evropian. Me vendosjen e rregullit "person i matur" si parim themelor për investimet në kapital dhe duke bërë të mundur që institucionet të veprojnë përtej kufijve, nxitet ridrejtimi i kursimeve në sektorin e ofrimit të pensioneve profesionale, duke kontribuar kështu në progresin ekonomik dhe shoqëror.

7. Rregullat e matura të përcaktuara në këtë direktivë synojnë të garantojnë një shkallë të lartë sigurie për pensionistët e ardhshëm përmes vendosjes të standardeve të rrepta mbikëqyrëse, si edhe të mundësojnë një menaxhim efikas të skemave të pensionit profesional.

8. Institucionet që janë plotësisht të shkëputura nga çdo veprimtari sponsorizimi dhe që funksionojnë mbi baza financimi vetëm me qëllim ofrimin e përfitimeve të pensionit, duhet të jenë të lira të ofrojnë shërbime dhe të investojnë, vetëm duke iu nënshtruar kërkesave, të koordinuara, për maturi, pavarësisht nëse këto institucione konsiderohen si persona juridikë.

9. Në përputhje me parimin e subsidiaritetit, shtetet anëtare duhet të marrin përgjegjësi të plotë për organizimin e sistemit të tyre të pensioneve, si dhe për vendimin mbi rolin e secilës prej tre "shtyllave" të sistemit të pensioneve në shtete anëtare të veçanta. Në kontekstin e shtyllës së dytë, ata duhet të mbajnë përgjegjësi të plotë edhe për rolin dhe funksionet e institucioneve të ndryshme që ofrojnë përfitime të pensionit profesional, të tilla si fonde pensioni të industrisë së gjerë, fonde pensioni të shoqërisë dhe shoqëritë e sigurimit të jetës. Kjo direktivë nuk ka për qëllim të vërë në pikëpyetje këtë të drejtë.

10. Rregullat kombëtare ndryshojnë për pjesëmarrjen e personave të vetëpunësuar në institucionet e pensionit profesional. Në disa shtete anëtare, institucionet e pensionit profesional mund të veprojnë në bazë të marrëveshjeve me tregtarë ose grupe tregtare, anëtarët e të cilëve veprojnë në cilësinë e të vetëpunësuarit ose drejtpërdrejtë me personat e vetëpunësuar dhe ata të punësuar. Në disa shtete anëtare, një person i vetëpunësuar mund të bëhet anëtar i një institucioni, kur personi i vetëpunësuar vepron si punëdhënës ose i ofron shërbimet e tij profesionale një sipërmarrjeje. Në disa shtete anëtare, personat e vetëpunësuar nuk mund të bëhen pjesë e një institucioni të pensionit profesional, me përjashtim të rasteve kur përmbushen disa kërkesa të caktuara, duke përfshirë edhe ato të përcaktuara nga e drejta shoqërore dhe ajo e punës.

11. Institucionet e administrimit të skemave të sigurimeve shoqërore, të cilat janë tashmë të koordinuara në nivel komuniteti, përjashtohen nga fusha e veprimit të kësaj direktive. Megjithatë, duhen marrë në konsideratë specifikat e institucioneve të cilat, në një shtet të vetëm anëtar, administrojnë si skemat e sigurimeve shoqërore ashtu edhe skemat e pensionit profesional.

12. Institucionet financiare, të cilat tashmë përfitojnë nga kuadri ligjor i Komunitetit, duhet të përjashtohen, në përgjithësi, nga fusha e veprimit të kësaj direktive. Megjithatë, meqë në disa raste këto institucione mund të ofrojnë shërbime të pensionit profesional, është e rëndësishme të sigurohet që kjo direktivë të mos sjellë shtrembërime të konkurrencës. Shtrembërime të tilla mund të shmangen duke zbatuar kërkesat e matura të kësaj direktive në fushën e pensioneve profesionale të shoqërive të sigurimit të jetës. Gjithashtu, komisioni duhet të monitorojë me kujdes situatën e tregut të pensioneve profesionale dhe të vlerësojë mundësinë e shtrirjes së zbatimit fakultativ të kësaj direktive edhe në institucione të tjera financiare të rregulluara.

13. Kur synohet garantimi i sigurisë financiare gjatë periudhës së pensionit, përfitimet e paguara nga institucionet për dhënien e pensionit profesional, duhet që zakonisht të sigurojnë pagesën e një pensioni

të përjetshëm. Duhet të mundësohen edhe pagesat për një periudhë të përkohshme ose pagesa e vlerës totale.

14. Është e rëndësishme të sigurohet që njerëzit e moshuar dhe me aftësi të kufizuara të mos rrezikohen nga varfëria dhe të gëzojnë një standard të denjë jetese. Një aspekt i rëndësishëm në luftën kundër varfërisë dhe pasigurisë mes personave të moshuar është edhe mbulimi i përshtatshëm nga risqet biometrike në skemat e pensioneve profesionale. Kur ngrihet një skemë pensionesh, punëdhënësit dhe punëmarrësit, ose përfaqësuesit e tyre përkatës, duhet ta konsiderojnë mundësinë që skema e pensioneve të përfshijë dispozita për mbulimin e rrezikut të jetëgjatësisë dhe rrezikut të paaftësisë për punë, si dhe dispozitat për personat e gjallë në ngarkim.

15. Mundësia që disa shtete anëtare të përjashtojnë nga objekti i legjislacionit të brendshëm institucionet që administrojnë skema të cilat, të marra së bashku, kanë më pak se 100 anëtarë në total, mund të lehtësojë mbikëqyrjen në disa shtete anëtare, pa cenuar funksionimin e duhur të tregut të brendshëm në këtë fushë. Megjithatë, kjo nuk duhet të cenojë të drejtën e këtyre institucioneve për të caktuar administratorë dhe kujdestarë investimi, të vendosur në një tjetër shtet anëtar dhe të autorizuar rregullisht, për administrimin e portofolit të tyre të investimit dhe për kujdestarinë e aktiveve të tyre.

16. Institucione të tilla si "Unterstützungskassen" në Gjermani, ku anëtarët nuk kanë të drejtë ligjore të përfitojnë nga një sasi e caktuar dhe kur interesat e tyre mbrohen nga një sigurim i detyrueshëm ligjor në rast falimenti, duhet të përjashtohen nga fusha e veprimtimit të kësaj direktive.

17. Me qëllim mbrojtjen e anëtarëve dhe përfituesve, institucionet e pensionit profesional duhet t'i kufizojnë veprimtaritë e tyre, dhe ato që rrjedhin prej tyre, në veprimtaritë e përmendura në këtë direktivë.

18. Në rast falimenti të një ndërmarrjeje sponsorizuese, një anëtar përballet me rrezikun e humbjes së vendit të tij/saj të punës dhe të të drejtave të tij/saj për pension. Kjo bën të domosdoshme ndarjen e qartë mes asaj ndërmarrjeje dhe institucionit, si dhe përcaktimin e standardeve minimale, të matura, për mbrojtjen e anëtarëve.

19. Mënyra sesi veprojnë dhe mbikëqyren institucionet e pensionit profesional ndryshon ndjeshëm nga njëri shtet anëtar në tjetrin. Në disa shtete anëtare, mbikëqyrja mund të ushtrohet jo vetëm mbi vetë institucionin, por edhe mbi subjektet apo kompanitë e autorizuara për administrimin e këtyre institucioneve. Shtetet anëtare duhet t'i marrin në konsideratë këto specifika, për sa kohë që të gjitha kërkesat e përcaktuara në këtë direktivë përmbushen në mënyrë efikase. Gjithashtu, shtetet anëtare duhet të jenë në gjendje të lejojnë shoqëritë e sigurimit dhe subjekte të tjera financiare të administrojnë institucionet e pensionit profesional.

20. Institucionet e dhënies së pensionit profesional janë ofrues të shërbimeve financiare, të cilët mbajnë një përgjegjësi të rëndë për ofrimin e përfitimeve të pensionit profesional dhe, rrjedhimisht, duhet të plotësojnë disa standarde minimale të matura në lidhje me veprimtarinë dhe kushtet e funksionimit të tyre.

21. Numri i madh i institucioneve në disa shtete anëtare, bën të domosdoshme gjetjen e një zgjidhjeje praktike për sa i përket autorizimit paraprak të institucioneve. Megjithatë, nëse një institucion dëshiron të administrojë një skemë në një tjetër shtet anëtar, duhet të kërkohet autorizim paraprak nga autoriteti kompetent i shtetit anëtar të origjinës.

22. Çdo shtet anëtar duhet të kërkojë që çdo institucion i vendosur në territorin e tij, të hartojë llogari dhe raporte vjetore duke marrë në konsideratë çdo skemë pensionesh që përdoret nga institucioni dhe, sipas rastit, llogari dhe raporte vjetore për secilën skemë pensionesh. Llogaritë dhe raportet vjetore, të cilat reflektojnë një pamje të vërtetë dhe të drejtë të aktiveve, detyrimeve dhe gjendjes financiare të institucionit, duke marrë në konsideratë çdo skemë të pensioneve që administrohen nga ai institucion, dhe të miratuara siç duhet nga një person i autorizuar, janë një burim thelbësor informacioni për anëtarët dhe përfituesit e skemës dhe autoritetet kompetente. Në veçanti, ato u mundësojnë autoriteteve kompetente të monitorojnë qëndrueshmërinë financiare të një institucioni dhe të vlerësojnë nëse institucioni është në gjendje të përmbushë të gjitha detyrimet e tij kontraktuale.

23. Informacioni i duhur është vendimtar për anëtarët dhe përfituesit e një skeme pensionesh. Kjo ka rëndësi të veçantë për kërkesat për informacion në lidhje me qëndrueshmërinë financiare të institucionit, rregullat kontraktuale, përfitimet dhe financimin real të përfitimeve që shkojnë për pensionet, politikën e investimeve dhe menaxhimin e risqeve dhe kostove.

24. Politika e investimeve e një institucioni është një faktor vendimtar si për sigurinë ashtu edhe për përbalimin e pensioneve profesionale. Rrjedhimisht, institucionet duhet të hartojnë dhe të shqyrtojnë, të paktën çdo tre vjet, një deklaratë të parimeve të investimit. Kjo deklaratë duhet t'u vihet në dispozicion autoriteteve kompetente, si dhe anëtarëve dhe përfituesve të çdo skeme pensionesh, me kërkesë të tyre.

25. Për të përmbushur funksionin e tyre ligjor, autoriteteve kompetente duhet t'u jepen të drejtat e duhura të informimit dhe kompetencat e ndërhyrjes në lidhje me institucionet dhe personat që i drejtojnë ato efektivisht. Kur një institucion që ofron pensione profesionale transferon funksione të rëndësishme, si administrimi i investimeve, teknologjia e informacionit ose kontabiliteti, te shoqëri të tjera (nënkontraktuese), atëherë të drejtat e informimit dhe kompetencat e ndërhyrjes duhet të zgjerohen në mënyrë që të mbulojnë këto funksione të nënkontraktuara, për të verifikuar nëse këto veprimtari po kryhen në përputhje me rregullat mbikëqyrëse.

26. Një kusht thelbësor për të siguruar përmbushjen e detyrimeve për pagesën e përfitimeve të pensionit është llogaritja e matur e provigjoneve teknike. Provigjonet teknike duhet të llogariten mbi bazën e metodave aktuariale të njohura dhe të certifikuara nga persona të kualifikuar. Normat maksimale të interesit duhet të zgjidhen me kujdes sipas rregullave kombëtare përkatëse. Shuma minimale e provigjoneve teknike duhet të jetë e mjaftueshme për përfitimet e paguara tashmë, në mënyrë që përfituesit të vazhdojnë të paguhet, si dhe të pasqyrojë angazhimet që lindin nga të drejtat e anëtarëve për të përfituar pension.

27. Risqet e mbuluara nga institucionet varjojnë ndjeshëm nga njëri shtet anëtar në tjetrin. Rrjedhimisht, shtetet anëtare të origjinës duhet të kenë mundësinë të llogarisin provigjonet teknike sipas rregullave më të hollësishme dhe në shtesë të atyre që përcaktohen në këtë direktivë.

28. Aktivitetet e mjaftueshme dhe të përshtatshme në mbulim të provigjoneve teknike mbrojnë interesat e anëtarëve dhe përfituesve të skemës së pensioneve në rast se ndërmarria sponsorizuese humbet aftësinë paguese. Në mënyrë të veçantë, në rastin e veprimtarisë ndërkufitare, njohja reciproke e parimeve mbikëqyrëse të zbatuara në shtetet anëtare kërkon që provigjonet teknike të financohen tërësisht gjatë gjithë kohës.

29. Nëse institucioni nuk ushtron veprimtari ndërkufitare, shtetet anëtare duhet të jenë në gjendje të lejojnë ofrimin e fondeve të pamjaftueshme, me kusht që të kenë një plan të posaçëm për të rivendosur financim të plotë dhe pa cenuar kërkesat e Direktivës së Këshillit 80/987/KEE të 20 Tetorit 1980, për

përafrimin e ligjeve të shteteve anëtare në lidhje me mbrojtjen e punëmarrësve në rast falimenti të punëdhënësit të tyre ⁽⁴⁾.

30. Në shumë raste, mund të jetë ndërmarrja sponsorizuese dhe jo vetë institucioni që mbulon çdo risk biometrik apo garanton përfitime të caktuara ose realizimin e investimeve. Megjithatë, në disa raste, është vetë institucioni që ofron mbulimin apo garanci të tilla dhe detyrimet e sponsorëve përgjithësisht përdoren për të paguar kontributet e nevojshme. Në këto rrethana, produktet e ofruara janë të ngjashme me ato të shoqërive të sigurimit të jetës dhe institucionet e lidhura duhet të zotërojnë të paktën të njëjtat fonde shtesë si edhe shoqëritë e sigurimit të jetës.

31. Institucionet janë investitorë shumë afatgjatë. Përgjithësisht, shlyerja e aktiveve në pronësi të këtyre institucioneve nuk mund të bëhet për ndonjë qëllim tjetër përveçse për ofrimin e përfitimeve të pensionit. Për më tepër, për të mbrojtur siç duhet të drejtat e anëtarëve dhe përfituesve, institucionet duhet të mund të zgjedhin atë alokim aktivesh që i përshtatet natyrës së saktë dhe kohëzgjatjes së detyrimeve të tyre. Këto aspekte kërkojnë një mbikëqyrje efikase dhe një qasje ndaj rregullave të investimeve, që u lejojnë institucioneve fleksibilitet të mjaftueshëm për të vendosur politikën më të sigurt dhe më efikase të investimeve dhe që i detyron ata të veprojnë me maturi. Kështu që, pajtueshmëria me rregullin "person i matur" kërkon një politikë investimesh të përshtatur me strukturën e anëtarësimin të institucionit individual të pensionit profesional.

32. Metodrat dhe praktikrat mbikëqyrëse ndryshojnë mes shteteve anëtare. Rrjedhimisht, shteteve anëtare duhet t'u jepet diskrecioni për të vendosur rregullat precize të investimeve, që ata dëshirojnë t'u vendosin institucioneve që ndodhen në territoret e tyre. Megjithatë, këto rregulla nuk duhet të kufizojnë lëvizjen e lirë të kapitalit, përveçse kur justifikohet mbi baza të matura.

33. Ashtu si investitorët shumë afatgjatë me risqe të ulëta të likuiditetit, edhe institucionet e pensioneve profesionale mund të investojnë në aktive jolikuide, siç janë aksionet, si dhe në tregje kapitali me risk, brenda kufijve të matura. Gjithashtu, ata mund të përfitojnë nga avantazhet e diversifikimit ndërkombëtar. Rrjedhimisht, investimet në aksione, në tregje me kapital të rrezikuar dhe në valutë tjetër, jo në atë të detyrimeve, nuk duhet të kufizohet, me përjashtim të rasteve kur ka baza të matura.

34. Megjithatë, nëse institucioni ushtron veprimtari ndërkufitare, autoritetet kompetente të shtetit anëtar priten mund t'i kërkojnë institucionit të aplikojë kufij për investime në aksione dhe aktive të ngjashme, që nuk janë pranuar për tregtim në një treg të rregulluar, në aksione dhe instrumente të tjera të emetuara nga e njëjta ndërmarrje ose në aktive të emëtuara në valuta që nuk përputhet, me kusht që këto rregulla të zbatohen edhe për institucionet që ndodhen në shtetin anëtar priten.

35. Kufizimet në lidhje me lirinë e zgjedhjes nga ana e institucioneve të administratorëve dhe kujdestarëve të aktiveve të miratuara, kufizojnë konkurrencën në tregun e brendshëm dhe, për këtë arsye, duhen eliminuar.

36. Pa cenuar legjislacionin kombëtar shoqëror dhe atë të punës për organizimin e sistemeve të pensioneve, duke përfshirë anëtarësimin e detyrueshëm dhe rezultatet e marrëveshjeve të negociatave kolektive, institucionet duhet të kenë mundësinë e ofrimit të shërbimeve në shtete të tjera anëtare. Atyre duhet t'u lejohej të pranojnë sponsorizime nga ndërmarrjet në shtete të tjera anëtare dhe të operojnë skemat e pensioneve me anëtarësim në më shumë se një shtet anëtar. Kjo mund të sjellë ekonomi të konsiderueshme të shkallës për këto institucione, të përmirësojë konkurrencën në industrinë e komunitetit dhe të lehtësojë lëvizjen e forcës punëtore. Gjë që kërkon njohje të ndërsjellë të standardeve të matura. Zbatimi i duhur i këtyre standardeve të matura duhet të mbikëqyret nga autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës, nëse nuk specifikohet ndryshe.

37. Ushtrimi i të drejtës së një institucioni në një shtet anëtar për të administruar një skemë pensionesh profesionale të kontraktuar në një tjetër shtet anëtar, duhet të respektojë plotësisht dispozitat e legjislacionit social dhe atij të punës në fuqi në shtetin anëtar pritës, për sa ka lidhje me pensionet profesionale, për shembull, për përkufizimin dhe pagesën e përfitimeve të pensioni dhe kushtet për transferimin e të drejtave të pensionit.

38. Kur një skemë është e blinduar, dispozitat e kësaj direktive zbatohen individualisht për këtë skemë.

39. Është e rëndësishme të merren masa për bashkëpunim ndërmjet autoriteteve kompetente të shteteve anëtare për qëllime të mbikëqyrjes, dhe ndërmjet atyre autoriteteve dhe komisionit për qëllime të tjera. Me qëllim që të kryejnë detyrat e tyre dhe të kontribuojnë në zbatimin e qëndrueshëm dhe në kohë të kësaj direktive, autoritetet kompetente duhet t'i sigurojnë njëri-tjetrit informacionin e nevojshëm për të zbatuar dispozitat e direktivës. Komisioni ka bërë të ditur qëllimin e tij për krijimin e një komiteti mbikëqyrësish, me qëllim nxitjen e bashkëpunimit, koordinimit dhe shkëmbimit të pikëpamjeve mes autoriteteve kompetente kombëtare, si dhe nxitjen e zbatimit të qëndrueshëm të kësaj direktive.

40. Meqë objektivi i kësaj mase të propozuar, konkretisht, krijimi i një kuadri ligjor të Komunitetit që mbulon institucionet e pensionit profesional, nuk mund të arrihen plotësisht kur shtetet anëtare veprojnë në mënyrë të njëanshme dhe ku, për shkak të shkallës dhe efekteve të veprimit, mund të arrihen më mirë në nivel Komuniteti, ky i fundit mund të miratojë masa në përputhje me parimin e subsidiaritetit, siç përcaktohet në nenin 5 të Traktatit. Në përputhje me parimin e proporcionalitetit, sipas përcaktimit në atë nen, kjo direktivë nuk shkon përtej asaj që është e nevojshme për arritjen e këtij objekti.

MIRATOJNË KËTË DIREKTIVË:

Neni 1

Objekti

Kjo direktivë përcakton rregullat për nisjen dhe ndjekjen e veprimtarive të ushtruara nga institucionet e pensionit profesional.

Neni 2

Fusha e zbatimit

1. Kjo direktivë zbatohet për institucionet që ofrojnë pension profesional. Kur, sipas legjislacionit të brendshëm institucionet për ofrimin e pensioneve profesionale nuk kanë personalitet juridik, atëherë shtetet anëtare e zbatojnë këtë direktivë për ato institucione ose, sipas paragrafit 2, për ato subjekte të autorizuara që janë përgjegjëse për administrimin e tyre dhe që veprojnë në emër të tyre.

2. Kjo direktivë nuk zbatohet për:

(a) institucionet që administrojnë skemat e sigurimeve shoqërore, që mbulohen nga Rregullorja (KEE) nr. 1408/71⁽⁵⁾ dhe Rregullorja (KEE) nr. 574/72⁽⁶⁾;

(b) institucionet që mbulohen nga Direktiva 73/239/KEE⁽⁷⁾, Direktiva 85/611/KEE⁽⁸⁾, Direktiva 93/22/KEE⁽⁹⁾, Direktiva 2000/12/KE⁽¹⁰⁾ dhe Direktiva 2002/83/KE⁽¹¹⁾;

(c) institucionet që funksionojnë sipas parimit "paguaj rast pas rasti";

(d) institucionet ku punonjësit e ndërmarrjeve sponsorizuese nuk kanë të drejta ligjore për përfitime dhe kur ndërmarrja sponsorizuese mund të shlyejë aktivet në çdo kohë dhe jo domosdoshmërisht të përmbushë detyrimet e saj për pagesën e përfitimeve për pension;

(e) shoqëritë që përdorin skema të librave rezervë me qëllim pagesën e përfitimeve të pensionit për punonjësit e tyre.

Neni 3

Zbatimi për institucionet që operojnë skema të sigurimeve shoqërore

Institucionet e ofrimit të pensionit profesional të cilat operojnë edhe skemat e detyrueshme të pensionit lidhur me punësimin të cilat konsiderohen si skema të sigurimeve shoqërore që mbulohen nga Rregulloret (KEE) nr. 1408/71 dhe (KEE) nr. 574/72, mbulohen nga kjo direktivë në lidhje me veprimtarinë e tyre të ofrimit të pensionit profesional jo të detyrueshëm. Në këtë rast, pasivet dhe aktivet përkatëse mbahen të veçuara dhe pa mundësi transferimi të skemat e detyrueshme të pensionit që konsiderohen si skema të sigurimeve shoqërore ose anasjelltas.

Neni 4

Zbatimi fakultativ për institucionet që mbulohen nga Direktiva 2002/83/KE

Shtetet anëtare të origjinës mund të zgjedhin të zbatojnë dispozitat e neneve 9 deri 16 dhe të eneve 18 deri 20 të kësaj direktive për veprimtarinë e tyre të ndërmarrjeve të sigurimit për ofrimin e pensioneve profesionale që mbulohen nga Direktiva 2002/83/KE. Në këtë rast, të gjitha aktivet dhe pasivet përkatëse të veprimtarisë në fjalë duhet të jenë të veçuara, të administrohen dhe organizohen të ndara nga veprimtaritë e tjera të ndërmarrjeve të sigurimeve, pa pasur mundësinë e transferimit.

Në këtë rast, dhe vetëm për veprimtarinë e tyre të ofrimit të pensioneve profesionale, ndërmarrjet e sigurimit nuk janë objekt i neneve 20 deri në 26, 31 dhe 36 të Direktivës 2002/83/KE.

Shteti anëtar i origjinës duhet të sigurojë që autoritetet kompetente ose autoritetet përgjegjëse për mbikëqyrjen e ndërmarrjeve të sigurimeve sipas Direktivës 2002/83/KE, të verifikojnë, si pjesë të punës së tyre mbikëqyrëse, ndarjen precize të veprimtarisë përkatëse të ofrimit të pensioneve profesionale.

Neni 5

Institucionet e vogla të pensionit dhe skemat ligjore

Me përjashtim të nenit 19, shtetet anëtare mund të zgjedhin të mos e zbatojnë këtë direktivë, plotësisht ose pjesërisht, për çdo institucion që ndodhet në territoret e tyre, i cili zbaton skemat e pensioneve profesionale, të cilat kanë më pak se 100 anëtarë në total. Megjithatë, sipas nenit 2, paragrafi 2, institucioneve të tilla duhet t'u jepet e drejta të zbatojnë vullnetarisht këtë direktivë. Neni 20 mund të zbatohet vetëm nëse zbatohen të gjitha dispozitat e tjera të kësaj direktive.

Shtetet anëtare mund të zgjedhin të mos zbatojnë nenet 9 deri 17 për institucione, kur ofrimi i pensionit profesional është i parashikuar në statut, sipas ligjit, dhe garantohet nga një autoritet publik. Neni 20 mund të zbatohet vetëm nëse zbatohen të gjitha dispozitat e tjera të kësaj direktive.

Përkufizimet

Për qëllimet e kësaj direktive:

(a) "institucioni i pensionit profesional", apo "institucioni", është një institucion, pavarësisht formës së tij ligjore, që vepron në bazë financimi, i themeluar veçmas nga çdo ndërmarrje sponsorizuese apo tregti, me qëllim ofrimin e përfitimeve të pensionit, në kontekstin e një veprimtarie profesionale, në bazë të një marrëveshje ose kontrate të rënë dakord:

- individualisht ose kolektivisht mes punëdhënësit/ve dhe punëmarrësit/ve ose përfaqësuesve të tyre përkatës, ose

- me personat e vetëpunësuar, në përputhje me legjislacionin e shteteve anëtare të origjinës dhe atyre pritës,

dhe që kryen veprimtari që lindin direkt prej tyre;

(b) "skemë pensionesh" është një kontratë, marrëveshje, deklaratë besimi ose rregullore që përcakton përfitimet që jepen për pension dhe kushtet në të cilat jepen;

(c) "ndërmarrje sponsorizuese" është çdo ndërmarrje apo organ tjetër, pavarësisht nëse përfshin ose përbëhet nga një ose më shumë persona fizikë ose juridikë, që vepron si punëdhënës apo në kapacitetet e të vetëpunësuarit, ose ndonjë ndërthurje të tyre, dhe që paguan kontribute në një institucion që ofron pension profesional;

(d) "përfitime pensioni" janë përfitime që paguhen kur arrin moshën e pensionit ose moshën e parashikuar të pensionit, kur janë plotësuese për këto përfitime dhe kur jepen si ndihmë, në formën e pagesave në rast vdekje, për paaftësi në punë, ose për ndërprerjen e punësimit ose në formën e pagesave apo shërbimeve mbështetëse në rast sëmundje, varfërie apo vdekje. Për të lehtësuar sigurinë financiare në moshën e pensionit, këto përfitime zakonisht marrin formën e pagesave për jetën. Megjithatë, mund të jenë edhe pagesa të bëra për një periudhë të përkohshme ose pagesa të vlerës totale.

(e) "anëtar" është një person që ushtron aktivitet profesional, i cili i jep ose do t'i japë të drejtën atij/asaj për përfitime pensioni, në përputhje me dispozitat e skemës së pensioneve;

(f) "përfitues" është një person që merr përfitime pensioni;

(g) "autoritete kompetente" janë autoritetet kombëtare të caktuara për të kryer detyrat e parashikuara në këtë direktivë;

(h) "risqe biometrike" janë risqet e lidhura me vdekjen, paaftësinë për punë dhe jetëgjatësinë;

(i) "shtet anëtar i origjinës" është shteti anëtar në të cilin institucioni ka selinë e regjistruar dhe administratën e tij bazë, ose, nëse nuk ka seli të regjistruar, ka administratën e tij bazë;

(j) "shtet anëtar pritës" është shteti anëtar, ku legjislacioni i tij përkatës shoqëror dhe i punës, në fushën e skemave të pensionit profesional, zbatohet për marrëdhëniet mes ndërmarrjes sponsorizuese dhe anëtarëve.

Neni 7

Veprimtaria e një institucioni

Çdo shtet anëtar i kërkon institucioneve që ndodhen brenda territorit të tij, të kufizojnë veprimtarinë e tyre vetëm në ato veprimtari dhe aktivitete që lidhen me përfitimet e moshës së pensionit dhe që lindin prej tyre.

Në përputhje me nenin 4, kur ndërmarrja e sigurimeve administron veprimtarinë e saj të ofrimit të pensioneve profesionale, duke mbajtur veçmas aktivet dhe pasivet e saj, këto aktive dhe pasive të veçuara duhet të jenë të lidhura me veprimtari dhe aktivitete që kanë të bëjnë direkt me përfitimet për moshën e pensionit dhe ato që lindin prej tyre.

Neni 8

Ndarja ligjore mes ndërmarrjeve sponsorizuese dhe institucioneve të pensioneve profesionale

Secili shtet anëtar sigurohet që të ketë një ndarje ligjore mes një ndërmarrjeje sponsorizuese dhe një institucioni të pensionit profesional, në mënyrë që aktivet e institucionit të mbrohen në interes të anëtarëve dhe përfituesve, në rast falimentimi të ndërmarrjes sponsorizuese.

Neni 9

Kushtet e punës

1. Secili shtet anëtar sigurohet, për çdo institucion që ndodhet në territorin e tij, që:

(a) institucioni të jetë i regjistruar në regjistrin kombëtar nga autoriteti kompetent mbikëqyrës ose i autorizuar; në rastin e veprimtarisë ndërkufitare, sipas nenit 20, në regjistër duhet të cilësohen edhe shtetet anëtare ku operon institucioni;

(b) institucioni drejtohet në mënyrë efektive nga persona me reputacion të mirë, që duhet të kenë kualifikimet dhe përvojën e duhur profesionale ose ka këshilltarë me kualifikime dhe përvojën e duhur profesionale;

(c) të jenë zbatuar rregullat e hartuara siç duhet për funksionimin e çdo skeme pensioni që operohet nga institucioni dhe anëtarët të kenë marrë informacionin e mjaftueshëm rreth këtyre rregullave;

(d) të gjitha provigjonet teknike të jenë llogaritur dhe certifikuar nga një aktuar ose, në mungesë të një aktuari, nga një specialist i fushës, duke përfshirë edhe një auditor, sipas legjislacionit të brendshëm, mbi bazën e metodave aktuariale që njihen nga autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës;

(e) kur ndërmarrja sponsorizuese garanton pagesën e përfitimeve të pensionit, ajo të angazhohet për financim të rregullt;

(f) anëtarët të marrin informacionin e nevojshëm rreth kushteve të skemës së pensioneve, në veçanti sa i përket:

(i) të drejtave dhe detyrimeve të palëve të përfshira në skemën e pensioneve;

(ii) risqeve financiare, teknike dhe risqeve të tjera që lidhen me skemën e pensioneve;

(iii) natyrës dhe shpërndarjes së këtyre risqeve.

2. Në përputhje me parimin e subsidiaritetit dhe duke marrë në konsideratë shkallën e përfitimeve të pensioneve të ofruara nga regjimet e sigurimeve shoqërore, shtetet anëtare mund të parashikojnë që opsioni i mbulimit të jetëgjatësisë dhe paaftësisë në punë, ofrimi për personat e gjallë në ngarkim dhe një garanci për ripagimin e kontributeve si përfitime shtesë, t'u ofrohen anëtarëve nëse kjo miratohet nga punëdhënësit dhe punëmarrësit ose nga përfaqësuesit e tyre përkatës.

3. Një shtet anëtar mund të vendosë kërkesa të tjera për kushtet e funksionimit të një institucioni që ndodhet në territorin e tij, me qëllim që të sigurohet që interesat e anëtarëve dhe përfituesve të kenë mbrojtjen e duhur.

4. Një shtet anëtar mund t'u lejojë ose t'u kërkojë institucioneve që ndodhen në territorin e tij që t'ua besojnë administrimin e këtyre institucioneve, qoftë tërësisht apo pjesërisht, subjekteve të tjera që operojnë në emër të këtyre institucioneve.

5. Në rastin e veprimtarisë ndërkufitare, të përmendur në nenin 20, kushtet e funksionimit të institucionit i nënshtrohen autorizimit paraprak të autoriteteve kompetente të shtetit anëtar të origjinës.

Neni 10

Llogaritë dhe raportet vjetore

Secili shtet anëtar i kërkon çdo institucioni që ndodhet në territorin e tij të hartojë llogari dhe raporte vjetore duke marrë në konsideratë çdo skemë pensionesh që administrohet nga institucioni dhe, kur është e zbatueshme, i kërkon llogari dhe raporte vjetore për secilën skemë pensionesh. Llogaritë dhe raportet vjetore duhet të japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë të aktiveve, detyrimeve dhe gjendjes financiare të institucionit. Llogaritë vjetore dhe informacioni i përfshirë në raport duhet të jetë konsekuent, gjithëpërfshirës, i paraqitur drejtë dhe i miratuar siç duhet nga personat e autorizuar, sipas legjislacionit të brendshëm.

Neni 11

Informacioni për anëtarët dhe përfituesit

1. Në varësi të natyrës së skemës së përcaktuar të pensioneve, secili shtet anëtar sigurohet që çdo institucion që ndodhet në territorin e tij të japë të paktën informacionin e përcaktuar në këtë nen.

2. Anëtarët dhe përfituesit dhe/ose, sipas rastit, përfaqësuesit e tyre marrin:

(a) me kërkesë të tyre, llogaritë dhe raportet vjetore të përmendura në nenin 10, dhe, kur një institucion është përgjegjës për më shumë se një skemë, llogaritë dhe raportet vjetore që lidhen me skemën e tyre specifike të pensioneve;

(b) çdo informacion përkatës në lidhje me ndryshimet në rregullat e skemës së pensioneve, brenda një kohe të arsyeshme.

3. Deklarata e parimeve të politikave të investimeve, e përmendur në nenin 12, u vihet në dispozicion anëtarëve dhe përfituesve dhe/ose, sipas rastit, përfaqësuesve të tyre, sipas kërkesës.

4. Gjithashtu, çdo anëtar merr, me kërkesë të tij, informacion të detajuar dhe real për:

- (a) nivelin e synuar të përfitimeve të pensionit, nëse ka;
- (b) nivelin e përfitimeve në rast të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës;
- (c) gamën e mundësive për investim, nëse ka, në rastin kur anëtari mbart riskun e investimeve, dhe për portofolin real të investimeve, si dhe informacion mbi ekspozimin ndaj riskut dhe kostove të lidhura me investimet;
- (d) masat që lidhen me transferimin e të drejtave të pensionit në një institucion tjetër të pensionit profesional, në rast ndërprerje të marrëdhënies së punës.

Anëtarët informohen shkurtimisht, çdo vit, mbi situatën e institucionit, si dhe për nivelin aktual të financimit të përfitimeve të tyre individuale që shkojnë për pension.

5. Në moshën e pensionit ose në momentin që i takojnë përfitime të tjera, çdo përfitues merr informacionin e duhur mbi përfitimet që i takojnë dhe mundësitë përkatëse të pagesës.

Neni 12

Deklarata e parimeve të politikave të investimit

Çdo shtet anëtar sigurohet që çdo institucion që ndodhet në territorin e tij të përgatisë dhe, të paktën çdo tre vjet, të rishikojë një deklaratë me shkrim për parimet e politikës së investimeve. Kjo deklaratë duhet të rishikohet, pa vonesë, pas çdo ndryshimi të rëndësishëm në politikën e investimeve. Shtetet anëtare sigurohen që kjo deklaratë të përmbajë, të paktën, çështje të tilla si metodat e matjes së riskut të investimeve, proceset e zbatuara të menaxhimit të riskut dhe alokimin strategjik të aktiveve në lidhje me natyrën dhe kohëzgjatjen e detyrimeve për pensionet.

Neni 13

Informacioni për autoritetet kompetente

Çdo shtet anëtar sigurohet që autoritetet kompetente të kenë kundrejt institucioneve që ndodhen në territorin e tij, kompetencat dhe mjetet e nevojshme për:

- (a) t'i kërkuar institucionit, anëtarëve të bordit të drejtorëve dhe administratorëve të tjerë ose drejtorëve apo personave që kontrollojnë institucionin, që të japin informacion në lidhje me të gjitha çështjet e punës së institucionit ose të dërgojnë të gjithë dokumentacionin e punës së institucionit;
- (b) të mbikëqyrur marrëdhëniet ndërmjet institucionit dhe shoqërive të tjera, ose ndërmjet institucioneve, kur institucionet transferojnë funksione drejt atyre shoqërive apo institucioneve të tjera (nënkontraktuese), që ndikojnë në gjendjen financiare të institucionit ose në mbikëqyrjen efikase të tij;
- (c) të marrë rregullisht deklaratën e parimeve të politikës së investimeve, llogaritë dhe raportet vjetore dhe të gjitha dokumentet e nevojshme për qëllime të mbikëqyrjes. Këtu përfshihen dokumente si:
 - (i) raportet e brendshme të përkohshme;
 - (ii) vlerësimet aktuariale dhe supozimet e detajuara;
 - (iii) studimet aktive-pasive;

- (iv) dëshmi të përputhshmërisë me parimet e politikave të investimeve;
- (v) dëshmi që kontributet janë paguar sipas planit;
- (vi) raporte nga personat përgjegjës për kontrollin e llogarive vjetore, të përmendura në nenin 10;
- (d) inspektime në ambientet e institucionit dhe, sipas rastit, në funksionet e nënkontraktuara, për të verifikuar nëse aktivitetet kryhen në përputhje me rregullat mbikëqyrëse.

Neni 14

Kompetencat e ndërhyrjes dhe detyrat e autoriteteve kompetente

1. Autoritetet kompetente i kërkojnë çdo institucioni që ndodhet në territorin e tyre që të zbatojë procedura të shëndosha administrative dhe kontabiliteti dhe të ketë mekanizmat e duhura të kontrollit të brendshëm.

2. Autoritetet kompetente kanë kompetencën të marrin të gjitha masat, duke përfshirë, sipas rastit, masa të natyrës administrative ose financiare, qoftë ndaj institucioneve që ndodhen në territoret e tyre apo edhe ndaj personave që i drejtojnë këto institucione, të cilat janë të përshtatshme dhe të nevojshme për të parandaluar ose korrigjuar çdo parregullsi që cenon interesat e anëtarëve dhe të përfituesve.

Gjithashtu, ata mund të kufizojnë ose ndalojnë shitjen e lirë të aktiveve të institucionit, në veçanti, kur:

(a) institucioni nuk ka arritur të vendosë provigjone të mjaftueshme teknike në lidhje me punën e tij ose kur nuk ka aktive të mjaftueshme në mbulim të provigjoneve teknike;

(b) institucioni nuk ka arritur të ruajë fondet e veta rregullatore.

3. Për të mbrojtur interesat e anëtarëve dhe përfituesve, autoritetet kompetente mund t'ia transferojnë, tërësisht ose pjesërisht, kompetencat e personave që drejtojnë një institucion që ndodhet në territoret e tyre, në përputhje me ligjin e shtetit anëtar të origjinës, një përfaqësuesi të posaçëm, i cili është i aftë të ushtrojë këto kompetenca.

4. Autoritetet kompetente mund të ndalojnë ose kufizojnë veprimtarinë e një institucioni që ndodhet në territoret e tyre, në mënyrë të veçantë, nëse:

(a) institucioni nuk arrin të mbrojë siç duhet interesat e anëtarëve dhe përfituesve;

(b) institucioni nuk i përmbush më kushtet e punës;

(c) institucioni shkel rëndë detyrimet e tij, që rrjedhin nga rregullat të cilave ai u nënshtrohet;

(d) në rastin e veprimtarisë ndërkufitare, institucioni nuk respekton kërkesat e legjislacionit shoqëror dhe atij të punës të shtetit anëtar pritës, lidhur me fushën e pensioneve profesionale.

Çdo vendim për të ndaluar veprimtarinë e një institucioni duhet të jetë i mbështetur në arsye precize dhe t'i njoftohet institucionit në fjalë.

5. Shtetet snëtare sigurohen që vendimet e marra në lidhje me një institucion, sipas ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative të miratuara në përputhje me këtë direktivë, t'i nënshtrohen të drejtës së ankimit në gjykatë.

Neni 15

Provigjone teknike

1. Shteti anëtar i origjinës sigurohet që institucionet që administrojnë skemat e pensioneve profesionale të krijojnë, në çdo kohë, për të gjithë gamën e skemave të pensioneve të tyre, një sasi të mjaftueshme pasivesh që korrespondon me angazhimet financiare që lindin nga portofoli i tyre i kontratave ekzistuese të pensioneve.

2. Shteti anëtar i origjinës sigurohet që institucionet që administrojnë skema të pensioneve profesionale, kur ato ofrojnë mbulim kundër risqeve biometrike dhe/ose garantojnë realizimin e investimeve ose një nivel të caktuar përfitimesh, të vendosin provigjone të mjaftueshme teknike për të gjithë gamën e këtyre skemave.

3. Llogaritja e provigjoneve teknike bëhet çdo vit. Megjithatë, shteti anëtar i origjinës mund të lejojë llogaritjen çdo tre vjet, nëse institucioni u ofron anëtarëve dhe/ose autoriteteve kompetente një certifikim ose raport për rregullimin e viteve të ndërmjetme. Certifikimi apo raporti pasqyron zhvillimin e rregulluar të provigjoneve teknike dhe ndryshimet në risqet e mbuluara.

4. Llogaritja e provigjoneve teknike kryhet dhe certifikohet nga një aktuar ose, në mungesë të një aktuari, nga një specialist tjetër i fushës, duke përfshirë edhe një auditor, sipas legjislacionit të brendshëm, mbi bazën e metodave aktuariale që njihen nga autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës, sipas parimeve të mëposhtme:

(a) shuma minimale e provigjoneve teknike llogaritet me anë të një vlerësimi aktuarial, të kryer me maturi të mjaftueshme, duke marrë në konsideratë të gjitha angazhimet për përfitime dhe për kontribute, në përputhje me skemat e pensioneve të institucionit. Kjo shumë duhet të jetë e mjaftueshme, që të vazhdojnë të paguhen pensionet dhe përfitimet që u paguhën përfituesve, si dhe që të pasqyrojë angazhimet që lindin nga të drejtat e anëtarëve për të përfituar pensione. Edhe supozimet ekonomike dhe aktuariale të përzgjedhura për vlerësimin e pasiveve duhet të zgjidhen me maturi, duke marrë në konsideratë, sipas rastit, marzhin e duhur për devijime negative;

(b) normat maksimale të interesit, që përdoren, zgjidhen me maturi dhe përcaktohen në përputhje me rregullat përkatëse të shtetit anëtar të origjinës. Këto norma të matura të interesit përcaktohen duke marrë parasysh:

- produktiviteti i aktiveve përkatëse në pronësi të institucionit dhe të ardhurat e ardhshme nga investimet dhe/ose

- norma e interesit të tregut të letrave me vlerë të cilësisë së lartë apo të letrave me vlerë të qeverisë;

(c) tabelat biometrike të përdorura për llogaritjen e provigjoneve teknike duhet të bazohen në parime të matura, duke pasur parasysh karakteristikat kryesore të grupit të anëtarëve dhe skemat e pensioneve, në veçanti, ndryshimet e pritshme të risqeve përkatëse;

(d) metoda dhe baza e llogaritjes së provigjoneve teknike mbetet përgjithësisht e pandryshueshme nga njëri vit fiskal në tjetrin. Megjithatë, ndërprerjet mund të justifikohen nga ndryshime të rrethanave ligjore, demografike apo ekonomike me bazë supozimet.

5. Shteti anëtar i origjinës mund të vendosë kërkesa shtesë dhe më të detajuara për llogaritjen e provigjoneve teknike, me qëllim që të sigurohet që interesat e anëtarëve dhe përfituesve të kenë mbrojtjen e duhur.

6. Me qëllim harmonizimit e mëtejshëm të rregullave për llogaritjen e provigjoneve teknike të cilat mund të justifikohen - në veçanti normat e interesit dhe supozime të tjera që ndikojnë në nivelin e provigjoneve teknike - çdo dy vjet ose me kërkesë të një shteti anëtar, Komisioni publikon çdo dy vjet ose me kërkesë të një shteti snëtar, një raport për situatën në lidhje me zhvillimin e veprimtarive ndërkufitare.

Komisioni propozon masat e nevojshme për të parandaluar shtrembërimet e mundshme, të shkaktuara nga nivelet e ndryshme të normave të interesit dhe për të mbrojtur interesat e përfituesve dhe anëtarëve të çdo skeme.

Neni 16

Financimi i provigjoneve teknike

1. Shteti anëtar i origjinës i kërkon çdo institucioni që të ketë në dispozicion, në çdo kohë, aktivet e duhura dhe të mjaftueshme në mbulim të provigjoneve teknike, për të gjithë gamën e skemave të pensioneve që institucioni administron.

2. Shteti anëtar i origjinës mund t'i lejojë një institucioni, për një periudhë të kufizuar kohe, të ketë aktive të pamjaftueshme në mbulim të provigjoneve teknike. Në këtë rast, autoritetet kompetente i kërkojnë institucionit të miratojë një plan konkret dhe të realizueshëm rimëkëmbjeje për t'u siguruar që kërkesat e paragrafit 1 plotësohen përsëri. Plani është objekt i kushteve të mëposhtme:

(a) institucioni harton një plan konkret dhe të realizueshëm për rivendosjen e shumës së kërkuar të aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike, në kohën e duhur. Plani u vihet në dispozicion anëtarëve ose, sipas rastit, përfaqësuesve të tyre dhe/ose i nënshtrohet miratimit të autoriteteve kompetente të sahtetit anëtar të origjinës;

(b) gjatë hartimit të planit, merret në konsideratë situata specifike e institucionit, në mënyrë të veçantë struktura e aktiveve/pasiveve, profili i riskut, plani i likuiditetit, profili i moshës së anëtarëve që kanë të drejtë të përfitojnë shumat e pensionit, skemat e nisjes dhe skemat që e ndryshojnë nga një plan pa financim ose me financim të pjesshëm në një plan me financim të plotë;

(c) në rast përfundimi të një skeme pensioni gjatë periudhës së përmendur më sipër në këtë paragraf, institucioni informon autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës. Institucioni vendos një procedurë për të transferuar aktivet dhe pasivet përkatëse në një institucion tjetër financiar apo në një organ të ngjashëm. Kjo procedurë u njoftohet autoriteteve kompetente të shtetit anëtar të origjinës dhe një përshkrim i përgjithshëm i procedurës u vihet në dispozicion anëtarëve ose, sipas rastit, përfaqësuesve të tyre, në përputhje me parimin e ruajtjes së konfidencialitetit.

3. Në rastin e veprimtarisë ndërkufitare, siç përmendet në nenin 20, provigjonet teknike duhet të jenë të financuara plotësisht, në çdo kohë, për të gjitha skemat e pensioneve në administrim. Nëse këto kushte

nuk plotësohen, autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës ndërhyjnë në përputhje me nenin 14. Për të përmbushur këtë kërkesë, shteti anëtar i origjinës mund të kërkojnë veçimin e aktiveve dhe pasiveve.

Neni 17

Fondet rregullatore vetjake

1. Shteti anëtar i origjinës sigurohet që institucionet që administrojnë skema pensionesh, ku vetë institucioni, dhe jo ndërmarrja sponsorizuese, pranon detyrimin për të ofruar mbulim kundër riskut biometrik apo garanton realizimin e një investimi të caktuar ose një nivel të caktuar përfitimesh, të ruajnë në mënyrë të përhershme aktivet shtesë, mbi ato në mbulim të këtyre provigjoneve teknike, që të shërbejnë si masë mbrojtëse. Shuma e tyre duhet të pasqyrojë llojin e riskut dhe bazën e aktiveve për të gjithë gamën e skemave në administrim. Këto aktive nuk do të ngarkohen me detyrime të parashikueshme dhe do të shërbejnë si kapital sigurie për të absorbuar mospërputhjet mes shpenzimeve dhe fitimeve të parashikuara dhe atyre reale.

2. Për qëllime të llogaritjes së shumës minimale të aktiveve shtesë, zbatohen rregullat e përcaktuara në nenet 27 dhe 28 të Direktivës 2002/83/KE.

3. Megjithatë, paragrafi 1 nuk i pengon shtetet anëtare t'u kërkojnë institucioneve që ndodhen në territorin e tyre të ruajnë fonde e veta rregullatore ose të vendosin rregulla më të hollësishme, me kusht që ato të justifikohen me maturi.

Neni 18

Rregullat e investimeve

1. Shtetet anëtare u kërkojnë institucioneve që ndodhen në territoret e tyre të investojnë në përputhje me rregullin "person i matur" dhe veçanërisht, në përputhje me rregullat e mëposhtme:

(a) aktivet duhet të investohen në interesin më të mirë të anëtarëve dhe përfituesve. Në rast të një konflikti interesi të mundshëm, institucioni ose subjekti që administron portofolin e tij, sigurohet që investimi të bëhet vetëm në interes të anëtarëve dhe përfituesve;

(b) aktivet duhet të investohen në një mënyrë të tillë që të garantojnë sigurinë, cilësinë, likuiditetin dhe rentabilitetin e portofolit në tërësi.

Edhe aktivet në mbulim të provigjoneve teknike, duhen investuar në një mënyrë që të përshtatet me natyrën dhe kohëzgjatjen e përfitimeve të pritshme të pensionit në të ardhmen;

(c) aktivet duhet të investohen kryesisht në tregje të rregulluara. Në çdo rast, investimi i aktiveve që nuk janë pranuar për tregtim në një treg të rregulluar financiar duhet të mbahet në nivele të matura;

(d) investimi i instrumenteve derivative duhet të lejohet për sa kohë që ato kontribuojnë në uljen e risqeve të investimit ose lehtësojnë administrimin efikas të portofolit. Ato duhet të vlerësohen me maturi, duke marrë në konsideratë aktivet bazë, dhe duhet të përfshihen në vlerësimin e aktiveve të institucionit. Gjithashtu, institucioni shmang ekspozimin e tepërt ndaj riskut kundrejt një pale tjetër të vetme dhe për veprimtari të tjera derivative;

(e) aktivet duhet të diversifikohen në mënyrë të tillë që të shmanget varësia e tepërt në ndonjë aktiv të veçantë, emetues ose grup ndërmarrjesh dhe akumulimi i risqeve në portofolin në tërësi.

Investimet në aktivet e emetuara nga i njëjti emetues ose nga emetues që i përkasin të njëjtit grup nuk duhet ta ekspozojnë institucionin ndaj përqendrimit të tepërt të riskut;

(f) investimi në ndërmarrje sponsorizuese nuk duhet të jetë më i madh se 5% e portofolit në tërësi dhe, kur ndërmarrja sponsorizuese është pjesë e një grupi, investimet në ndërmarrjet që i përkasin të njëjtit grup me ndërmarrjen sponsorizuese, nuk duhet të tejkalojnë 10% të portofolit.

Kur institucioni sponsorizohet nga disa ndërmarrje, investimi në këto ndërmarrje sponsorizuese duhet të bëhet me maturi, duke marrë në konsideratë nevojën për diversifikimin e duhur.

Shtetet anëtare mund të vendosin të mos i zbatojnë kërkesat e përmendura në geramat (e) dhe (f) për investime në obligacione qeveritare.

2. Shteti anëtar i origjinës e ndalon institucionin të marrë hua ose të veprojë si dorëzanës për llogari të të tretëve. Megjithatë, shtetet anëtare mund të autorizojnë institucione që të marrin hua vetëm për qëllime likuiditeti dhe në mënyrë të përkohshme.

3. Shtetet anëtare nuk u kërkojnë institucioneve që ndodhen në territorin e tyre të investojnë në kategori të veçanta aktivesh.

4. Pa cenuar nenin 12, shtetet anëtare nuk i bëjnë objekt të miratimeve paraprake të çdo lloji apo të kërkesave për njoftim sistematik, vendimet për investime të një institucioni që ndodhet në territorin e tyre apo të administratorit të tij të investimit.

5. Në përputhje me dispozitat e paragrafëve 1 deri në 4, për institucionet që ndodhen në territorin e tyre, shtetet anëtare mund të përcaktojnë rregulla më të hollësishme, duke përfshirë rregullat sasiore, me kusht që ato të jenë të justifikuara me maturi, për të pasqyruar të gjithë gamën e skemave të pensioneve që administrohen nga këto institucione.

Në veçanti, shtetet anëtare mund të zbatojnë dispozita për investime të ngjashme me ato të direktivës 2002/83/KE.

Megjithatë, shtetet anëtare nuk i pengojnë institucionet:

(a) të investojnë deri në 70% të aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike ose të të gjithë portofolit për skemat ku anëtarët bartin riskun e investimeve në aksione, tituj të negociueshëm që trajtohen si aksione dhe obligacione të korporatave të pranuar për tregtim në tregje të rregulluara dhe për përcaktimin e peshës përkatëse të këtyre titujve në portofolin e tyre të investimeve. Gjithsesi, shtetet anëtare mund të aplikojnë një limit më të ulët, me kusht që kjo të argumentohet me maturi, për institucionet që ofrojnë produkte pensioni me një garanci afatgjatë të normës së interesit, bartin riskun e investimeve dhe japin vetë garancinë;

(b) të investojnë deri në 30% të aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike në aktive që nuk janë në të njëjtën monedhë me atë në të cilën janë shprehur pasivet;

(c) të investojnë në tregjet e kapitalit me risk.

6. Paragrafi 5 nuk u heq shteteve anëtare të drejtën për të kërkuar zbatimin ndaj institucioneve që ndodhen në territorin e tyre, qoftë edhe në mënyrë individuale, me kusht që këto rregulla të argumentohen me maturi dhe të marrin parasysh sidomos detyrimet e marra përsipër nga institucioni.

7. Në rastin e një veprimtarie ndërkuftare, të përmendur në nenin 20, autoritetet kompetente të çdo shteti anëtar pritës mund të kërkojnë që rregullat e përcaktuara në nënparagrafin e dytë, të zbatohet për institucionin në shtetin anëtar të origjinës. Në këtë rast, këto rregulla zbatohen vetëm për atë pjesë të aktiveve të institucionit që korrespondon me veprimtaritë e ushtruara në atë shtet anëtar pritës. Për më tepër, ato zbatohen vetëm nëse zbatohen rregulla të njëjta ose më të rrepta edhe për institucionet që ndodhen në shtetin anëtar pritës.

Rregullat e përmendura në nënparagrafin e parë janë si më poshtë:

(a) institucioni nuk duhet të investojë më shumë se 30% të këtyre aktiveve në aksione, tituj të tjerë që trajtohen si aksione dhe tituj borxhi që nuk janë pranuar për tregtim në një treg të rregulluar, ose institucioni investon të paktën 70% e këtyre aktiveve në aksione, tituj të tjerë që trajtohen si aksione dhe tituj borxhi që janë pranuar për tregtim në një treg të rregulluar;

(b) institucioni duhet të investojë jo më shumë se 5% të këtyre aktiveve në aksione dhe tituj të tjerë që trajtohen si aksione, obligacione, tituj borxhi dhe instrumente të tjera valutore dhe të tregut të kapitalit të emetuara nga e njëjta ndërmarrje dhe jo më shumë se 10% të këtyre aktiveve në aksione dhe tituj të tjerë që trajtohen si aksione, obligacione, tituj borxhi dhe instrumente të tjera valutore dhe të tregut të kapitalit të emetuara nga ndërmarrjet që i përkasin një grupi të vetëm;

(c) institucioni nuk duhet të investojë më shumë se 30% të këtyre aktiveve në aktive që nuk janë në të njëjtat monedha me ato në të cilat janë shprehur detyrimet.

Për të përmbushur këto kërkesa, shteti anëtar i origjinës mund të kërkojë veçimin e aktiveve.

Neni 19

Administrimi dhe kujdestaria

1. Shtetet anëtare nuk i pengojnë institucionet që të emërojnë, për administrimin e portofolit të investimeve, administrues investimi që janë të vendosur në një tjetër shtet anëtar dhe që janë të autorizuar siç duhet për këtë veprimtari, në përputhje me Direktivat 85/611/KEE, 93/22/KEE, 2000/12/KE dhe 2002/83/KE, si dhe ato që përmenden në nenin 2, paragrafi 1, të kësaj direktive.

2. Shtetet anëtare nuk i pengojnë institucionet të emërojnë, për kujdestarinë e aktiveve të tyre, kujdestarë që janë të vendosur në një tjetër htet nëtar dhe që janë të autorizuar siç duhet në përputhje me Direktivën 93/22/KEE ose Direktivën 2000/12/KE, ose që pranohen si depozitar për qëllime të Direktivës 85/611/KEE.

Dispozita e përmendur në këtë paragraf nuk e pengon shtetit anëtar të origjinës ta bëjë të detyrueshëm emërimin e një depozitari ose kujdestari.

3. Çdo shtet anëtar merr hapat e nevojshëm për të bërë të mundur që sipas legjislacionit të tij të brendshëm të ndalohet, në përputhje me nenin 14, shitja e lirë e aktiveve të ruajtura nga depozitari ose kujdestari që ndodhet brenda territorit të tij, me kërkesë të një institucioni të shtetit anëtar të origjinës.

Veprimtaritë ndërkufitare

1. Pa cenuar legjislacionin e brendshëm shoqëror dhe atë të punës, për organizimin e sistemeve të pensioneve, duke përfshirë edhe anëtarësimin e detyrueshëm dhe rezultatet e marrëveshjeve të negociatave kolektive, shtetet anëtare u lejojnë ndërmarrjeve të vendosura në territorin e tyre të sponsorizojnë institucionet e pensionit profesional të autorizuara në shtete të tjera anëtare. Gjithashtu, ato u lejojnë edhe institucioneve të pensionit profesional, të autorizuara në territoret e tyre, të pranojnë sponsorizimin nga ndërmarrjet e vendosura në territoret e shteteve të tjera anëtare.

2. Një institucion që dëshiron të pranojë sponsorizimin nga një ndërmarrje e sponsorizuar që ndodhet në territorin e një shteti tjetër anëtar, duhet të marrë autorizim paraprak nga autoritetet kompetente të shtetit të tij anëtar të origjinës, sipas nenit 9, paragrafi 5. Ai duhet të njoftojë autoritetet kompetente të shtetit anëtar ku është i autorizuar, se ka për qëllim të pranojë sponsorizimin nga një ndërmarrje sponsorizuese e vendosur në territorin e një shteti tjetër anëtar.

3. Shtetet anëtare u kërkojnë institucioneve që ndodhen në territorin e tyre dhe që kanë paraqitur propozimin të sponsorizohen nga një ndërmarrje që ndodhet në territorin e një shteti tjetër anëtar, të japin informacionin e mëposhtëm në njoftimin e dërguar sipas paragrafit 2:

(a) shtetin/shtetet anëtare pritëse;

(b) emrin e ndërmarrjes sponsorizuese;

(c) karakteristikat kryesore të skemës së pensioneve që do të administrohet për ndërmarrjen sponsorizuese.

4. Kur një autoritet kompetent i shtetit anëtar të origjinës njoftohet sipas paragrafit 2, dhe nëse nuk ka arsye për të dyshuar se struktura administrative ose gjendja financiare e institucionit apo reputacioni i mirë dhe kualifikimet profesionale apo përvoja e personave që drejtojnë institucionin nuk janë në përputhje me veprimtarinë e propozuar në shtetin anëtar pritës, atëherë ai, brenda tre muajve nga marrja e të gjithë informacionit të përmendur në paragrafin 3, ua komunikon këtë informacion autoriteteve kompetente të shtetit anëtar pritës dhe informon përkatësisht edhe institucionin.

5. Përpara se institucioni të fillojë të zbatojë një skemë pensioni për një ndërmarrje sponsorizuese në një tjetër shtet anëtar, autoritetet kompetente të shtetit anëtar pritës, brenda dy muajve nga marrja e informacionit të përmendur në paragrafin 3, informojnë autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës, nëse është e përshtatshme, për kërkesat përkatëse të legjislacionit shoqëror dhe atij të punës në fushën e pensioneve profesionale, sipas të cilave duhet të administrohet skema e pensioneve e sponsorizuar nga një ndërmarrje në shtetin anëtar pritës dhe çdo rregull që duhet të zbatohet në përputhje me paragrafin 7 të nenit 18 dhe me paragrafin 7 të këtij neni. Autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës ua komunikojnë institucioneve këtë informacion.

6. Më marrjen e komunikimit, të përmendur në paragrafin 5, ose nëse nuk dërgohet asnjë komunikim nga autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës pas mbarimit të afatit të parashikuar në paragrafin 5, institucioni mund të fillojë të zbatojë skemën e pensioneve të sponsorizuar nga një ndërmarrje në shtetin anëtar pritës, në përputhje me kërkesat e legjislacionit shoqëror dhe atij të punës të shtetit anëtar pritës, në fushën e pensioneve profesionale, dhe çdo rregull që duhet të zbatohet në përputhje me paragrafin 7 të nenit 18 dhe me paragrafin 7 të këtij neni.

7. Në veçanti, një institucion i sponsorizuar nga një ndërmarrje e vendosur në një tjetër shtet anëtar duhet të zbatojë, në lidhje me anëtarët përkatës, të gjitha kërkesat për informacion që autoritetet kompetente të shtetit anëtar pritës u kanë vendosur institucioneve të vendosura në atë shtet anëtar, në përputhje me nenin 11.

8. Autoritetet kompetente të shtetit anëtar pritës informojnë autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës për çdo ndryshim të rëndësishëm të kërkesave lidhur me skemat e pensioneve profesionale të legjislacionit shoqëror dhe atij të punës të shtetit anëtar pritës, të cilat mund të ndikojnë në karakteristikat e skemës së pensioneve, për pjesën që ka lidhje me administrimin e skemës së pensioneve të sponsorizuar nga një ndërmarrje në shtetin anëtar pritës dhe të çdo rregulli që duhet të zbatohet, në përputhje me paragrafin 7 të nenit 18 dhe me paragrafin 7 të këtij neni.

9. Institucioni është objekt i mbikëqyrjes së vazhdueshme nga autoritetet kompetente të shtetit anëtar pritës, për sa i përket përputhshmërisë së veprimtarive të tij me kërkesat e legjislacionit shoqëror dhe atij të punës të shtetit anëtar pritës, për qsa ka lidhje me skemat e pensioneve profesionale, të përmendura në paragrafin 5 dhe me kërkesat për informacion, të përmendura në paragrafin 7. Nëse nga kjo mbikëqyrje rezultojnë parregullsi, autoritetet kompetente të shtetit anëtar pritës informojnë menjëherë autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës. Autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës, në bashkëpunim me autoritetet kompetente të shtetit anëtar pritës, marrin masat e nevojshme për t'u siguruar që institucioni të ndalojë shkeljet e legjislacionit shoqëror dhe atij të punës, që janë konstatuar.

10. Nëse, pavarësisht masave të marra nga autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës ose për shkak se mungojnë masat e duhura në shtetin anëtar të origjinës, institucioni vazhdon të shkelë dispozitat e zbatueshme të legjislacionit shoqëror dhe atij të punës, në fushën e skemave të pensioneve profesionale, të shtetit anëtar pritës, atëherë autoritetet kompetente të këtij të fundit, pasi të njoftojnë autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës, mund të marrin masat e duhura për të parandaluar apo për të vendosur penalitete për parregullsi të mëtejshme, duke përfshirë, për sa kohë është e domosdoshme, ndalimin e institucionit për të ushtruar veprimtarinë në shtetin anëtar pritës për ndërmarrjen sponsorizuese.

Neni 21

Bashkëpunimi mes Shteteve Anëtare dhe Komisionit

1. Shtetet anëtare sigurohen, në mënyrë të përshtatshme, për zbatimin uniform të kësaj direktive nëpërmjet shkëmbimit të rregullt të informacionit dhe përvojës, me qëllim zhvillimin e praktikave më të mira në këtë sferë dhe për një bashkëpunim më të ngushtë, duke parandaluar kështu shtrembërimet e konkurrencës dhe krijimin e kushteve të nevojshme për anëtarësim ndërkufitar pa probleme.

2. Komisioni dhe autoritetet kompetente të shteteve anëtare bashkëpunojnë ngushtë me qëllim lehtësimin e mbikëqyrjes së veprimtarive të institucioneve të pensionit profesional.

3. Secili shtet anëtar informon Komisionin për çdo vështirësi madhore që lind nga zbatimi i kësaj direktive.

Komisioni dhe autoritetet kompetente të shteteve anëtare në fjalë shqyrtojnë këto vështirësi sa më shpejt të jetë e mundur, me qëllim gjetjen e një zgjidhjeje të përshtatshme.

4. Katër vjet pas hyrjes në fuqi të kësaj direktive, Komisioni nxjerr një raport që vlerëson:

- (a) zbatimin e nenit 18 dhe progresin e arritur në përshtatjen e sistemeve mbikëqyrëse kombëtare, dhe
- (b) zbatimin e nënparagrafit të dytë të nenit 19(2), në veçanti për situatën mbizotëruese në shtetet anëtare, në lidhje me përdorimin e depozituesve dhe rolin e tyre, kur është e nevojshme.
5. Autoritetet kompetente të shtetit anëtar priten mund t'u kërkojnë autoriteteve kompetente të shtetit anëtar të origjinës të vendosin për veçimin e aktiveve dhe pasiveve të institucionit, siç parashikohet në paragrafin 3 të nenit 16, dhe në paragrafin 7 të nenit 18.

Neni 22

Zbatimi

1. Shtetet anëtare miratojnë ligjet, rregulloret dhe dispozitat administrative të nevojshme për të siguruar përputhshmërinë me këtë direktivë, përpara datës 23 shtator 2005. Ato njoftojnë menjëherë Komisionin për këtë.

Shtetet anëtare, në miratimin e këtyre masave, i referohen direktivës ose i shoqërojnë ato me një referencë në rastin e botimit zyrtar të tyre. Mënyrat për bërjen e një reference të tillë përcaktohen nga vetë shtetet anëtare.

2. Shtetet anëtare i komunikojnë Komisionit tekstin e dispozitave kryesore të legjislacionit kombëtar që ato miratojnë në fushën që rregullohet nga kjo direktivë.

3. Shtetet anëtare mund të shtyjnë deri më 23 shtator 2010 zbatimin e nenit 17, paragrafi 1 dhe 2 për institucionet që ndodhen në territorin e tyre, të cilat, në datën e cituar në paragrafin 1 të këtij neni, nuk disponojnë nivelin minimal të fondeve rregullatore vetjake të nevojshme, në pajtim me nenin 17, paragrafi 1 dhe 2. Megjithatë, institucionet që dëshirojnë të ushtrojnë veprimtari ndërkufitare në administrimin e skemave të pensionit, sipas nenit 20, nuk mund ta bëjnë këtë, për sa kohë që nuk janë në përputhje me rregullat e kësaj direktive.

4. Shtetet anëtare mund të shtyjë deri më 23 shtator 2010 zbatimin e nenit 18, paragrafi 1, germa f, për institucionet që ndodhen në territorin e tyre. Megjithatë, institucionet që dëshirojnë të ushtrojnë veprimtari ndërkufitare në administrimin e skemave të pensionit, sipas nenit 20, nuk mund ta bëjnë këtë, për sa kohë që nuk janë në përputhje me rregullat e kësaj direktive.

Neni 23

Hyrja në fuqi

Kjo direktivë hyn në fuqi në datën e botimit të saj në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian.

Neni 24

Marrësit

Kjo direktivë u drejtohet shteteve anëtare.

Nënshkruar në Luksemburg, më 3 Qershor 2003.

Për Parlamentin Evropian

Presidenti

P. Cox

Për Këshillin

Presidenti

N. Christodoulakis

(1) *Gazeta Zyrtare C 96 E, 27.3.2001, f. 136.*

(2) *Gazeta Zyrtare C 155, 29.5.2001, f. 26.*

(3) Opinioni i Parlamentit Evropian i 4 Korrikut 2001 (*Gazeta Zyrtare C 65 E, 14.3.2002, f. 135*), qëndrimi i përbashkët i Këshillit i 5 Nëntorit 2002 (ende i pabotuar në *Gazetën Zyrtare*) dhe vendimi i Parlamentit Evropian i 12 Marsit 2003 (ende i pabotuar në *Gazetën Zyrtare*) dhe vendimi i Këshillit i 13 Majit 2003.

(4) *Gazeta Zyrtare L 283, 28.10.1980, f. 23.* Direktiva e ndryshuar së fundmi me Direktivën 2002/74/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit (*Gazeta Zyrtare L 270, 8.10.2002, f. 10*).

(5) Rregullore e Këshillit (KEE) nr. 1408/71 e 14 Qershorit 1971 për zbatimin e skemave të sigurimeve shoqërore për personat e punësuar, të vetë-punësuarit dhe për anëtarët e familjeve të tyre që lëvizin brenda Komunitetit (*Gazeta Zyrtare L 149, 5.7.1971, f. 2*). Rregullore e ndryshuar së fundmi me Rregulloren (KE) nr. 1386/2001 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit (*Gazeta Zyrtare L 187, 10.7.2001, f. 1*).

(6) Rregullore e Këshillit (KEE) nr. 574/72 e 21 Marsit 1972 që rregullon procedurën për zbatimin e Rregullores (KEE) nr. 1408/71 për zbatimin e skemave të sigurimeve shoqërore për personat e punësuar, të vetë-punësuarit dhe për anëtarët e familjeve të tyre që lëvizin brenda Komunitetit (*Gazeta Zyrtare L 74, 27.3.1972, f. 1*). Rregullore e ndryshuar së fundmi me Rregulloren e Komisionit (KE) nr. 410/2002 (*Gazeta Zyrtare L 62, 5.3.2002, f. 17*).

(7) Direktiva e parë e Këshillit 73/239/KEE e 24 Korrikut 1973 për koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative që lidhen me ngritjen dhe ndjekjen e punës së sigurimeve të drejtpërdrejta, përveç sigurimit të jetës (*Gazeta Zyrtare L 228, 16.8.1973, f. 3*). Direktiva e ndryshuar së fundmi me Direktivën 2002/13/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit (*Gazeta Zyrtare L 77, 20.3.2002, f. 17*).

(8) Direktiva e Këshillit 85/611/KEE e 20 Dhjetorit 1985 për koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative, që lidhen me ndërmarrjet e investimeve kolektive në tituj të transferueshëm (SIKTT) (*Gazeta Zyrtare L 375, 31.12.1985, f. 3*). Direktiva e ndryshuar së fundmi me Direktivën 2001/108/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit (*Gazeta Zyrtare L 41, 13.2.2002, f. 35*).

(9) Vendimi i Këshillit 93/22/KEE i 10 Majit 1993 për shërbimet e investimeve në fushën e titujve (*Gazeta Zyrtare L 141, 11.6.1993, f. 27*). Direktiva e ndryshuar së fundmi me Direktivën 2000/64/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit (*Gazeta Zyrtare L 290, 17.11.2000, f. 27*).

(10) Direktiva 2000/12/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 20 Marsit 2000 për ngritjen dhe ndjekjen e punës së institucioneve kreditore (*Gazeta Zyrtare L 126, 26.5.2000, f. 1*). Direktiva e ndryshuar me Direktivën 2000/28/KE (*Gazeta Zyrtare L 275, 27.10.2000, f. 37*).

(11) Direktiva 2002/83/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 5 Nëntorit 2002 për sigurimin e jetës (*Gazeta Zyrtare L 345, 19.12.2002, f. 1*).